



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1810/2 Prot.

Tiranë, më 26/06 /2025

V E N D I M

Nr. 28, datë 26.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR MBYLLJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË INXHINIERI FIZIKE, NË DEPARTAMENTIN E
INXHINIERISË FIZIKE, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE
INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të MASR Nr. 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike me Nr. 53/3 Prot., Nr. 08, datë 14.04.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.06.2025,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për mbylljen e programit të studimit, Master Profesional në Inxhinieri Fizike, në Departamentin e Inxhinierisë Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, i cili nuk ka qenë aktiv për më shumë se dy vite akademike të njëpasnjëshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

